



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Ligjit, nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ Komunal duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Duke konsideruar krijimin e një mekanizmi të përkohshëm administrativ si një përgatitje të nevojshme për themelimin e komunës së re të Mitrovicës Veriore dhe duke theksuar se Komunës së Mitrovicës i janë dërguar njoftimet e nevojshme nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me Kapitullin 10, nenin 74 të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore

1. Themelohet Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore (ZAMV), që do të udhëhiqet nga një Zyrëtar Kryesor Ekzekutiv, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Mitrovicës Veriore, siç përcaktohet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe ashtu siç renditen në Koncept Dokumentin e bashkangjitur. Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore do të ekzistojë deri në themelimin e Komunës së Mitrovicës Veriore, ose derisa të vendoset ndryshe nga Qeveria.
2. Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore do të financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe do të krijohet si një njësi e veçantë buxhetore, siç përcaktohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Buxhetet që janë alokuar më parë për financimin e Administratës së Përkohshme të UNMIK-it në Mitrovicë do të transferohen në buxhetin e ZAMV.
3. Përveç tjerash, Qeveria do të alokojë drejtpërdrejt nga Buxheti Qendror i Kosovës deri në 1,000,000.00 € në këtë vit fiskal, për të mbështetur infrastrukturën e përgjithshme dhe sensibilizimin në Mitrovicën Veriore, që do të shpenzohen nëpërmjet ZAMV. Për të adresuar një mungesë të investimeve prej një dekade në infrastrukturë publike, një shumë ekuivalente do të alokohet për çdo vit në 5

vitet e ardhshme buxhetore për Mitrovicën Veriore, përmes ZAMV për aq kohë sa do të ekzistoj ose Komunës së Mitrovicës Veriore. Qeveria do të mbështesë kërkesat shtesë për përkrahje financiare të bëra nga ZAMV sipas nevojës dhe realizueshmërisë.

4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, përderisa të gjitha ministritë tjera janë të obliguara t'i ofrojnë Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore mbështetjen e nevojshme në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë. Përveç kësaj, Komuna e Mitrovicës do të jetë e obliguar të bëjë çdo dhe të gjitha transferet e nevojshme në Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore, apo të ndërmarr ndonjë masë tjetër të duhur, siç kërkohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në pajtueshmëri me nenin 74 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera për zbatimin Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Projektligjin për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 30,000.00 euro për organizimin e Bursës së Punësimit për vitin 2012.
2. Organizimi i Bursës së Punësimit kryhet nga Aleanca Kosovare për Biznes e cila financohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren nga kodi 431 subvencione dhe transfere në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe barten në xhirollogarinë e Aleancës Kosovare për Biznes, në Bankën Kombëtare Tregtare në numrin e xhirollogarisë 1903363750031145.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Përfundimtar për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga erërat në komunat Istog, Klinë dhe Pejë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

**PER SHPALLJEN E MONUMENTIT TË NATYRËS ME RËNDËSI TË VEÇANTË
"UJËVARAT E MIRUSHËS"**

1. Ujëvarat e Mirushës shpallen monument i natyrës me rëndësi të veçantë.
2. Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës" (tutje: Monument i Natyrës) merret nën mbrojtje si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera unike dhe reprezentative me 16 liqene dhe 12 ujëvara të ndarë në mes veti, me karakteristika të veçanta gjeologjike, gjeomorfologjike, speleologjike, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, si dhe me vlera shkencore, kulturore, peizazhore, sportive, rekreative dhe turistike.
3. Monumenti i Natyrës, përfshinë sipërfaqen prej 598.4 ha dhe shtrihet në territorin e komunave: Klinë, Malishevë dhe Rahovec.
4. Kufiri i Monumentit të Natyrës është i vijëzuar në hartën topografike në Shtojcën I. në përpjesëtim 1: 25.000, kurse ngastrat kadastrale të cilat përfshihen në Monumentin e Natyrës, janë në Shtojcën II. dhe janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
5. Paraqitja hartografike me kufijtë e vijëzuar të Monumentit të Natyrës, ruhet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

6. Në territorin e Monumentit të Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtës sipas zonave:
 - 6.1. zonë e parë - zbatohet në pjesët e territorit të Monumentit të Natyrës me vlera të larta gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike dhe lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipeve të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër;
 - 6.2. zonë e dytë - menaxhimi aktiv - zbatohet në pjesët të territorit të Monumentit të Natyrës që karakterizohet me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen veprimtari të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes;
 - 6.3. zonë e tretë- shfrytëzim i qëndrueshëm - zbatohet në territorin e Monumentit të Natyrës të paraparë për ndërtim të objekteve për pushim, rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Monumentit të Natyrës si dhe shfrytëzim të limituar dhe selektiv të të mirave të natyrës;
 - 6.4. zonë e ndikimit - hapësira prej 50 metrave nga kufiri i Monumentit të Natyrës që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në Monumentin e Natyrës.
7. Përcaktimi i regjimeve të mbrojtjes bëhet me Planin hapësinor të Monumentit të Natyrës.
8. Monumentit i Natyrës regjistrohet në Regjistrin për Vlerat e Mbrojtura të Natyrës të cilin e mbanë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
9. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Aktvendimi mbi Vënien në Mbrojtje të Pjesës së Territorit të Kanionit të Lumit Mirusha Degës së Lumit nga ana e majtë të Drinit të Bardhë (pjesa e cila i takon Komunës së Klinës) në Park Regjional të Natyrës Numër: 01-633-1, 24. maj 1982 (GZKSAK nr.31/82) dhe Vendimi i Kuvendit Komunal të Rahovecit mbi Vënien në Mbrojtje - në Park Regjional Natyror Pjesën e Kanionit të Lumit Mirusha - Degën e Majtë të Drinit të Bardhë (pjesa që i takon Komunës së Rahovecit) 01 nr. 290-1, 30 dhjetor 1982 (GZKSAK nr.8/83)
10. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për shtimin e listës të Aneksit A të Ligjit nr. 03/L-220 për Normën e Tatimit të Akcizës në Kosovë me këto mallra dhe norma si vijon:
 - 1.1. Thasët (qeset) me numër 3923210000, 3923291000 dhe 3923299000 tre euro për çdo kg;
 - 1.2. Gomat e përdorura me numër 4012110000, 4012120000, 4012130090 dhe 4012200090 pesë euro për çdo copë dhe
 - 1.3. Poqët elektrik me numrin tarifor 8539221000, 8539229000 dhe 8539299200 0.3 euro për çdo copë.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës në pajtim me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Doganor dhe Akcizës nr. 03/L-109, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë